



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE, JURIDIK DHE SHËRBIMEVE

Nr. 490 prot.

Durrës, më 14 .03 .2025

URDHËR

NR.32 DATË 14.03.2025

PËR

“HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT”

Në mbështetje të ligjit nr.10109, datë 02.04.2009 “Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë, Ligjit të Nënpunësit Civil Nr. 152/2013 (I ndryshuar), VKM Nr. 859, datë 26.12.2024 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, Planit të Veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe pasaportës së treguesve të performances, Urdhrit nr 446 datë 18.12.2019 “Për miratimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare”, Urdhrit nr 157 datë 19.12.2023 “Për miratimin e Kodit të Etikës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare”.

URDHËROJ

- 1- Ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit për Drejtorinë e Përgjithshme Detare, në kuadër të masave të parashikuara në planin e veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe pasaportës së treguesve të performancës, strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit 2024-2030.

Grupi i punës do të përbëhet nga:

- Z.Muharrem Trupja (Kryetar)
- Znj.Markela Kurti (Anëtar)
- Znj.Ergis Kryekurti (Anëtar)
- Z.Elidon Xhafa (Anëtar)

- Z.Henri Hasani (Anëtar)

3.Grupi i punës për Integritetin në Drejtorinë e Përgjithshme Detare do të hartojë një plan integriteti për institucionin, në mbështetje të Metodologjisë së Vlersimit të Riskut të Integritetit për Institucionet e qeverisjes qendrore dhe do t'ia dorëzojë atë Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, brënda datës 15.04.2025.

4.Të gjithë nënpunësit e institucionit duhet të mbështesin grupin e punës përgjate procesit të zhvillimit të planit të integritetit në institucion

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV.DREJTOR I PËRGJITHSHËM & KAPITEN I PORTEVE**

TOMOR HARIZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE, JURIDIK DHE SHËRBIMEVE

Nr. 393/1 Prot.

Durrës, 17 . 03 . 2025

Lënda: Kthim përgjigje: Mbi zbatimin e Planeve të Integritetit gjatë vitit 2024.

**MINISTRISË SË SHTETIT PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE
ANTIKORRUPSIONIN**

Tiranë

Për dijeni:

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Tiranë

Në bazë të shkresës suaj me nr 1018 Prot datë 18.02.2025 mbi monitorimin e zbatimit të Planeve të Integritetit gjatë vitit 2024 dhe përgatitja e raportit të monitorimit drejtuar institucioneve të qeverisjes qendrore, si dhe me shkresën 1506/1 date 03.03.2025 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë mbi “Monitorimin e zbatimit të Planeve dhe përgatitjen e raportit të monitorimit të Integritetit për vitin 2024”, ju bëjmë me dije se:

Drejtoria e Përgjithshme Detare nuk ka pas Plan dhe Koordinator Integriteti për vitin 2024, ndërkohe që me urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm nr 32 datë 17.03.2025 është ngritur grupi I punës për Hartimin e Planit dhe Raportit të Integritetit për periudhën 2025-2027 dhe me urdhërin nr 33 datë 17.03.2025 është caktuar Znj. Ferdoza Izvira, Koordinator I Integritetit për Drejtorinë e Përgjithshme Detare. (Bashkalidhur urdhërat)

Duke iu falenderuar për bashkëpunimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV.DREJTOR I PËRGJITHSHËM DHE KAPITEN I PORTEVE
TOMOR HARIZI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE, JURIDIK DHE SHËRBIMEVE**

Nr. 931 prot.

Durrës, më. 17 . 03 . 2025

URDHËR I BRENDSHËM

NR.33 DATË 17.03.2025

PËR

“CAKTIMIN E KOORDINATORIT PËR MONITORIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT”

Në mbështetje ligjit nr.10109, datë 02.04.2009 “Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, urdhrit nr 446 datë 18.12.2019 “Për miratimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare”, urdhrit nr 157 datë 19.12.2023 “Për miratimin e Kodit të Etikës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare”, si dhe urdhrit nr.32, datë 17.03.2025 "Për miratimin e Planit të Integritetit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare 2025 - 2027".

URDHËROJ

1. Caktimin e Znj.Ferdoza Izvira si Kordinator për monitorimin e Planit të Integritetit për Drejtorinë e Përgjithshme Detare 2025-2027.
2. Koordinatori do të jetë përgjegjës për monitorimin e Planit të Integritetit dhe hartimin e një raporti vjetor për situatën e aktiviteteve dhe masave që duhet të merren gjatë realizimit të secilit aktivitet.
3. Koordinatori do të mbështetet sipas rastit edhe nga punonjësit e secilës Drejtori.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV.DREJTOR I PËRGJITHSHËM & KAPITEN I PORTEVE**

TOMOR HARIZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE, JURIDIK DHE SHËRBIMEVE

Nr. 492 prot.

Durrës, më. 17 . 03 . 2025

NJOFTIM

Objekti: Njoftim i punonjësve për të ndërmarrë aktivitete që kanë si qëllim zhvillimin e Planit të Integritetit për Drejtorinë e Përgjithshme Detare.

Drejtuar: Të gjithë punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme Detare

Të nderuar kolegë të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, në kuadër të angazhimeve për parandalimin e korrupsionit, po përgatitet Plani i Integritetit 2025-2027.

Në këtë drejtim, ne ju informojmë se është lëshuar Urdhëri i brendshëm me nr.32 datë 17.03.2025 për përgatitjen e planit të integritetit dhe është ngritur grupi i punës për hartimin e këtij plani për Drejtorinë e Përgjithshme Detare.

Me urdhërin e brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm me nr.33 datë 17.03.2025, Koordinator i Integritetit është caktuar Znj. Ferdoza Izvira Drejtoreshë, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbeshtetese, dhe si anëtarë të grupit të punës për hartimin e planit të integritetit janë caktuar:

- 1.Z.Muharrem Trupja (Kryetar)
- 2.Znj.Markela Kurti (Anëtar)
- 3.Znj.Ergis Kryekurti (Anëtar)
- 4.Z.Elidon Xhafa (Anëtar)
- 5.Z.Henri Hasani (Anëtar)

Në mënyrë që Grupi i Punës për Integritetin të mbledhë informacion gjithëpërfshirës dhe të dhëna të nevojshme për të hartuar planin e integriteti, kërkoj mbështetjen, ndihmën dhe pjesëmarrjen aktive të të gjithë të punonjësve të institucionit tonë. Theksoj se të gjithë punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme Detare kanë detyrimin për të bashkëpunuar me Grupin e Punës për realizimin me sukses të procesit të zhvillimit të planit të integritetit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV.DREJTOR I PËRGJITHSHËM & KAPITEN I PORTEVE

TOMOR HARIZI

